



Në datë 21 mars dhe në datë 28 mars 2024 u mbajt në Tiranë, Takimi kombëtar në kuadër të projektit Rritja e cilësisë së arsimit dhe trajnimit në EJK – EQET SEE dhe u mbështet nga Agjencia Austriake për Zhvillim me fondet e Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim. Në këto takime u prezantua dokumenti “Praktikat e mira evropiane në zbatimin e metodologjive të vlerësimit të jashtëm” dhe është koleksioni i praktikave të mira që mbulon shembuj të ndryshëm në zbatimin e metodologjive të vlerësimit të jashtëm në rajonin e Evropës Juglindore: Shqipëri, Bosnja dhe

Herzegovina, Kosova*, Mali i Zi, Republika e Maqedonisë së Veriut, Serbi, Republika e Moldavisë dhe disa vende të Bashkimit Evropian.

Qëllimi i takimeve kombëtare ishte të zhvilloheshin diskutimet në grupin e ekspertëve, duke prezantuar dokumentin rajonal të praktikave të mira evropiane dhe të Evropës Juglindore për të përzgjedhur praktikat më të mira që i përshtaten kontekstit dhe nevojave të kornizës kombëtare të vlerësimit. Të lehtësojë përshtatjen dhe integrimin e këtyre praktikave dhe mjeteve më të mira të identifikuar në sistemin kombëtar të vlerësimit, duke siguruar përafrimin me politikat dhe procedurat ekzistuese.



Pasi u diskutua dhe u hartua metodologjia e zgjedhjes së praktikave, grupi i ekspertëve mbylli takimet duke përzgjedhur me konsensus për të dyja sistemet arsimore (arsimi profesional dhe arsimi i mesmëm i përgjithshëm), praktikat e nevojshme dhe më të përshtatshme për tu integruar në vijim në metodologjinë e vlerësimit të jashtëm në Shqipëri.